V E N D I M
Nr. 195, datë 16.4.1993

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 284 DATË 25.6.1992 "PËR RIFILLIMIN E PROCESIT TË PRIVATIZIMIT"

Me propozimin e Ministrisë së Transporteve dhe të Komunikacioneve, të Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 284, datë 25.6.1992 "Për rifillimin e procesit të privatizimit", pika 2 ndryshohet si vijon:

"Kalimi i pronës shtetërore në private dhe dhënia me qira e saj të bëhet nëpërmjet ankandit. Traktorët dhe mekanika bujqësore, pikat e riparimit, hangarët e mjeteve të mekanikës bujqësore, ofiçinat e ndërmarrjeve të mekanikës bujqësore e të ndërmarrjeve bujqësore dhe qendrat e karburanteve, ndërmarrjet mekanike, të makineri-transportit, parqet automobilistike të mjeteve të sistemit të transporteve e komunikacioneve dhe të ndërtimit, strehimit dhe rregullimit të territorit t'u ofrohen për blerje, në radhë të parë, punonjësve që i kanë aktualisht në përdorim dhe, vetëm në rast se këta nuk i blejnë, të dalin në ankand".

2. Vlera e objekteve që privatizohen (autokombajnat, pikat e riparimit, hangarët e mjeteve të mekanikës bujqësore, qendrat e karburanteve, buldozerët, ekskavatorët, dumperat, pikat e riparimit, pikat e karburantit të ndërtimit e të transportit) të mos korrigjohet me indeksin e çmimit të konsumit.

3. Shitja e objekteve sipas këtij vendimi mund të bëhet me këste.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 10.8.1992 dhe nr. 128, datë 13.3.1992, shfuqizohen.

5. Për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve, Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, të nxjerrin udhëzimin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi